



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:049993
Datë: 28.12.2022
Numri i dokumentit: 03804351

C.nr.445/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Shaban Shala, me praktikantin A.B. duke vendosur në çështjen juridike të paditësit A.R. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.Sh. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e pagave jubilarë, me vlerë të kontestit 204,38 €, pas dhënies së përgjigjes në padi, më datë 27.12.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesë padia e paditësit **A.R.** nga fshati Komuna e Prizrenit dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që në emër të shpërblimit jubilar t’ia paguajë shumën në lartësi prej **204,38 €** (dyqind e katër euro e tridhjetë e tetë cent), në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit.

II. DETYROHET e paditura që t’ia paguajë paditësit shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 124 € (njëqind e njetetë e katër euro) në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi A.R. nga fshati Komuna e Prizrenit të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.Sh. nga Prizreni, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, për kompensimin e pagave jubilarë, me vlerë të kontestit 204,38 €.

E paditura duke vepruar sipas aktvendimit të gjykatës më dt.12.04.2021 ka dorëzuar në gjykatë përgjigjen në padi me anë të së cilës e ka kundërshtuar në parim padinë dhe kërkesë padinë e paditësit me arsyetim të mos shterjes së mjeteve juridike pranë organeve administrative dhe në mungesë të mjeteve buxhetore ngase Ministria e Financave nuk ka kod të posaqëm buxhetor për këtë kategori të shpenzimeve.

Paditësi padisë ia ka bashkangjitur provat materiale si në vijim: kërkesën për kompensimin e pagës jubilarë drejtuar Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren të datës 04.03.2021, vërtetimin për përvojën e punës pranë shkollës SHFMU “Ekrem Rexha” në dhe tri pagat mujore bruto për muajt Nëntor 2020, Dhjetor 2020 dhe Janar 2021 të datës 25.02.2021 lëshuar nga SHFMU “Ekrem Rexha”, kopjen e letërnjoftimit, përgjigjen (vendimin) e të paditurës me numër 741/21 të datës 09.03.2021 lidhur me kërkesën e paditësit për kompensimin e pagave jubilarë, kërkesën për pagesën e shpenzimeve në emër të pagave jubilarë drejtuar SHFMU “Ekrem Rexha” në me numër 726/21 të datës 09.03.2021 dhe autorizimin.

Nga provat e administruara më lartë nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura SHFMU “Ekrem Rexha” në Komuna e Prizrenit, në cilësi të punëtorit teknik-ndihmës, por mbetet kontestues fakti se paditësit a i takon shpërblyimi jubilar për punë, për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, për shkak se kjo kërkesë e paditësit është e rregulluar me dispozita të Kontratës Kolektive të Arsimit nr.01/B-105 të datës 22.01.2021 konkretisht të nenit 35 par.8, i cili rregullon çështjen e pagesës së pagave jubilarë.

Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqjese dhe gjendjen faktike të vërtetuar, se paditësi është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura dhe ka mbi 23 vite përvojë pune, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesë padinë e paditësit, ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit t’ia paguaj shumën në lartësi prej 204,38 €.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenit 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 124 € dhe atë në emër të përpilimit të padisë 104 € dhe në emër të taksës për padi 20 € bazuar në tarifën e OAK-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
-Departamenti i përgjithshëm-
C.nr.445/21, më datë 27.12.2022

Praktikanti
Ardi Brando

Gjyqtari
Shaban Sh. Shala

UDHËZIME PËR ANKESË: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.